



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPŠTINA OPŠTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal
Z/znj _____


Në bazë të dispozitave te nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e nëntë të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më: **31.10.2023.** (E marte)
duke filluar ne ora **10:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Raporti Financiar për tremujorit të tretë të vitit 2023 (Korrik-Shtator);
3. Prezentimi i Dreft Rregullores për organizim dhe sistematizim e mbremshem të vendeve të punes në administraten komunale të NB-së;
4. Me kerkes të Komitetit të Komuniteteve është Propozuar kjo pikë për Rend Dite:
Diskutimi i Problem-it rrëthë demtimit të Rruges Prekoc-Stanishor (për KPF dhe K.K) ;
5. Ndyshimi dhe plotsimi i Rregullores mbi Taksat, Obligimet dhe Denimet Komunale;
6. Të ndryshme.



Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.


Më: 20.10.2023
Në: Novobërdë



**Kryesuese e Kuvendit
Mirjana Simijonović**

PIKOI - 1

Procesverbali i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Novobërdë
Opština Novo Brdo-Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPŠTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tetë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më: 26.09.2023, me fillim nga ora 10:10.

Kryesuesja Mirijana Simijonoviq pasi përshëndeti të pranishmti tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës për aprovim para disa ditëve kanë ndodhur disa ekcese në territorin e Kosovës, unë si kryesuese e Kuvendit po ashtu edhe Kryetari i Komunës e denojmë sulmin ndaj policisë së Kosovës, të gjithë e dimë kohën në të cilën po jetojmë askujt prej neve nuk i duhen këto raste po ashtu edhe sulmet ndaj personave zyrtar, ne si anëtarë të Kuvendit jemi zgjedhur nga qytetarët të mundohemi të jetojmë në një mejdis të mirë, atë çfarë po presim, ditët në vijim, të qetësohet situata dhe të jetojmë në një ambient të qetë.

Në mbledhje morën pjesë: Kryetarja e Kuvendit, znj. Mirjana Simijonoviq, nënkyetari i Kuvendit, z. Ramush Mehmeti, Stefan Kovaçevic, Stojan Stanojeviq, Ivana Ivanoviq, Dragana Dimiq Violeta Milosheviq, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanoviq, Milica Jovanoviq, Selatin Nuhiu Dobrivoje Gjorgjeviq, Vlora Vllasaliu, Abdyl Gashi, Ivica Ceniq, Dr. Srboljub Gjokiq, Drejtor i Financave z. Millosh Deniq, zyrtar i lartë i Drejtorisë së Financave, z. Zoran Cvetkoviq, kryetar i Drejtorisë së Kadastrit, Urbanistikës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Selatin Beqiri, Drejtori i bujqësisë përfaqësues i OSBE-së, zyrtarë komunalë dhe qytetarë.

Pasë kësaj e konfirmoi kuroumin, e hapi mbledhjen me këtë:

Rendite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të Komunës për vitin 2024/2026;
3. Raport mbi përfundimin e fushatës së korrije-shirjeve;
4. Miratimi i vendimit për konfirmimin e vazhdimit të Memorandumit të Mirëkuptimit me shoqatën e zjarrfikësve vullnetarë nga Gjilani;
5. Të ndryshme.

Abdyl Gashi pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të aprovohet rendi i ditës kërkoj që të mbahet një minutë heshtje për policin i cili është vrarë në detyrë.

Kryesuesja tha: Unë edhe më herët e ceka në emrin tim, anëtarëve të Kuvendit dhe Kryetarit të Komunës ju shpreha ngushllime për incidentin I cili ka ndodhur në territorin e Kosovës.

Ramush Mehmeti pasi përshëndeti të pranishmit tha: Mendoj që porpozimi është i mirë po ashtu pajtohem me diskutimin paraprak që shprehët ngushllime është një aktë shumë i mirë, demokratik, real por nuk mendoj se do të prishë punë edhe një minutë heshtje.

Procesverbali i Kuvendit

Kryesuesja tha: Pasi jemi në një situatë të palakmueshme edhe të habitur, gjithsesi të gjithë ne po i presim hetimet, se çfarë ka ndodhur kanë humbur jetë dhe nuke duhet të bëhtë askush i lumtur, gjithësesi të gjithë denojmë këto akte, ju shprehëm ngushllime dhe të mundohemi të jetojmë në një ambient të qetë, në komunën tonë kemi një atmosferë mjaftë të mirë mes veti, nuk kemi probleme, të mundohemi të punojmë në komunitetin tonë, ju kolegët që porpozuan jeni në rregull, unë edhe njëherë po e ceki që ju shpreh ngushllime, po ashtu edhe në emër të Kryetarit të Komunës ju shpreh ngushllime, të gjithë ne e denojmë sulmin ndaj personave zyrtar, nuk është dashur të ndodhë askushë nga ne nuk e dëshiron këtë, të jemi të singertë këto dy ditë siç po ndodhë edhe në komunitetin serbë po ashtu shqiptar dhe të gjithë komunitetet që jetojnë në Kosovë askush nuk ka fjetur i qetë, të gjithë kanë familje, fëmijë të gjithë dëshirojnë të jetojnë të lumtur, askushë nuk dëshironë situatë të tensionuar, ne nuk jemi ata që ju kemi gëzuar situatës por kemi shprehur ngushllime kështu që ne si Kuvend kemi bërë mjaftë të shprehim ngushllime.

Abdyl Gashi tha: Ju kuptoj që keni shqetësimë por nuk mendoj që do të jeni të shqetësuar për një minutë heshtje dhe kjo duhet të bëhet me krenari pasi që na përfaqësoni në institucionet e Republikës së Kosovës, ai zyrtar policor ka qenë pjesë e institucioneve ka ndrruar jetë duke e mbrojtur vendin, nga bandat kriminale dhe kjo dhe besoj që duhet të kemi një minutë heshtje, edhe ju edhe ne po kontribojmë për punën tonë, në bazë të Rregulloreve Ligjeve të Republikës së Kosovës, andaj ju ftoj si përfaqësues për një minutë heshtje ju faleminderit.

Kryesuesja tha: Të mos keqkuptohemi ka pasur shumë viktima, ka pasur ditë zie për viktimat që kanë humbur jetë, askush nga ne nuk e dinë se çfarë ka ndodhur me të vërtetë, ne dimë atë çfarë kemi ndëgjuar nga mediat dhe një policë e ka humbur jetën dhe nga ana tjetër ka viktima tjera të plagosur dhe nuk e dimë se çfarë me të vërtetë ka ndodhur. Ne si përfqësues të Kuvendit që jemi zgjedhur nga qytetarët e kësaj komune të vogël, të mundohemi të punojmë për këta qytetarë dhe të mos krijojmë shqetësimë të ndërsjella, të jemi të civilizuar, të presim që hetime të përfundojnë dhe të gjithë ne dëshirojmë të ndëgjojmë se çfarë ka ndodhur me të vërtetë dhe pse ka ndodhur. Çfarë dua t'ju them për të cilën du t'ju tërheq vëmendjen, ne si anëtar që qytetarët e presin nga ne të Komunës së Novobërdës të sillemi si njerëz të civilizuar dhe atyre t'ju themi që besojmë në institucionet e Kosovës që do ti gjejnë fajtorët, t'i gjejnë arsyet pse ka ndodhur, sa i përket neve ne i denojmë incidentet, ka pasur dit zie ka pasur viktima, mirpo mos të futemi në konflikte tjera, të jemi të parët që qytetartë të janë të knaqur me ne, unë si Kryesuese e Kuvendit që më keni votuar ju lus mos të debatojmë më shumë e kemi edhe aporvimin e buxhetit për vitin e ardhshmëm, e dimë që jemi në një situatë mjaftë të rëndë, e gjithë kjo çfarë ka ndodhur është e vështirë, miérpo në komunën tonë e kemi jetojmë e kemi një situatë shumë të qetë, mundohemi që t'ju ndihmojmë njëri tjetrit dhe punojmë për të mirën e gjithë komuniteteve, mendoj që është e mjaftueshme, që në si institucion kemi shprehur ngushllime s'bashku me Kryetarin e Komunës.

Ramush Mehmeti tha: Edhe më herët e ceka që e keni dhënë një mendim demokratik kemi shprehur keqardhje për policin i cili ka rënë në detyrë, pajtohem me Abdylin që një minutë heshtje nuk do të dëmtojë procesin të ngriteri në këmbë dhe të mbajmë një minutë heshtje.

Pasi nuk pati diskutime tjera është mbajtur një minutë heshtje për ndër të policit i cili ka rënë në detyrë.

Kryesuesja tha: Me kërkesë të Kryetarit e kamë një propozim që të futet në rend dite pika shtesë, prurja e vendimit për ndalimin e përkohshëm e shitjeve së parcelave që kanë objekte pa leje deri në legalizim të objektit. Të gjithë ne e dimë që në Komunën tonë, përballemi me një numër të madhë, të problemeve sa i përket pronave, sidomos pasi kemi shumë shembuj që po ndodhin që

Procesverbali i Kuvendit

po tjetërsohen disa pasuri, e cila theksohet në familjen e përbashkët sa i përket femrave, ka ndodhur që prona është tjetërsuar të themi pa praninë e bashkshortes, për këtë fjalën ja dha drejtorit të urbanizmit.

Drejtori i urbanizmit Sllobodan Bogdanoviq pasi përshëndeti të pranishmti tha: Kemi pasur raste ku gruaja nuk ka mundur të japë dëshmi për pronësinë për ndertimin e objektit pa leje, burri i saj e ka shitur shtëpinë dhe ajo nuk ka trashëguar asgjë, ajo nuk ka pasur dëshmi që s'bashku e kanë ndërtuar shtëpinë, shtëpia nuk ka qenë e legalizuar parcela ka qenë bujqësore, ajo është tjetërsuar, pasi ka pasur afatë për legalizim deri në vitin 2018 ne kemi planifikuar që t'i ndalojmë shitjen e përkoshme të parcelave deri në zgjidhjen e statutit.

Kryesuesja tha: Me sa e kuptova Kuvendi të merrë vendim për ndalimin e përkohshëm të shitjeve të parcelave që kanë objekte pa leje.

Ramush Mehmeti tha: Si propzim është i arsyeshëm por kërkoj nga Drejtoria që ta konsulton edhe Ligjin, pasi nëse marrim ndonjë vendim jashtë Ligjit atëher edhe ne jemi përgjëgjës për këtë. Këto raste duhet të janë në harmoni me Ligjin, unë jamë për mirpëo duhet të konsultohet Ligji ju faleminderit.

Selatin Nuhiu pasi përshëndeti të pranishmit tha: Është dashur më herët te jetë kjo pikë në rend dite, sepse e dimë në komunën tonë se çfarë keqpërdorime janë bërë, ndërtimë pa leje, ka keqpërdorime shumë të mëdha, këto po bëhen zakonishtë nga zyrtarët komunal dhe nëse kjo lejohet mendoj që është një venndim shumë i qëlluar që ka propozuar Kryetari është kjo kërkesë, sepse duhet të ndalohen ndërtimet të cilat janë pa leje, zyrtarët komunal po i keqpërdorin pozitat.

Abdyl Gashi tha: Këto propozime që po vijnë brenda Kuvendit janë të padrejta pasi fatkeqësishtë edhe nuk i kemi Drejtorët që janë bazuar në Rregulloret, nuk është aq e thjeshtë që të marrim vendime, duhet të sqarohen gjërat, pasi që MAPL-ja po i kthen mbrapa vendimet dhe kush po del këtu me keq anëtarët e Kuvendit.

Parnvera Kastarti pasi përshëndeti të pranishmit tha: Sa i përket kësaj pike kërkoj 15 minuta pauzë që t'i shikojmë dokumentet dhe pastaj të votojmë.

Stojan Stanojeviq Pasi përshëndeti të pranishmit tha: Kryesuesja e paraqiti pikën e rendit të ditës, rregullorja e punës e lejon këtë dhe mendoj që të futet në rend dite kjo pikë dhe pasë kësaj mundë të bisedojmë ju faleminderit.

Kryesuesja tha: Administrata e Kuvendit mundohet që materialin t'ju dorëzon anëtarve të Kuvendit 7 ditë para mbledhjes, por ndodhë që ditën e fundit (mbledhjes) po ka propozime që të futen në rend dite edhe pika tjera, si Kuvend kemi të drejtë të marrim vendim nese pika propozohet brenda mbledhjes ju faleminderit.

Pasi nuk pati diskuitme tjera me 14 vota për 1 kundër u u futë edhe kjo pikë në rend dite Prurja e vendimit për ndalimin e përkohshëm të shitjeve së parcelave që kanë objekte pa leje deri në legalizim të objektit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime procerverbali u aprova njëzëri nga anëtarët e K.K-së.

Pika e dytë: Shqyrthimi dhe miratimi i buxhetit të Komunës për vitin 2024/2026.

Kryesuesja për këtë pikë fjalën ja dha drejtorit të financave.

Drejtori i financave Millosh Deniq pasi përshëndeti të pranishmit tha: Sa I përket kësaj pike materialin ju kemi dërguar me kohë, që ta shqyrtoni dhe aproponi buxhetin e komunës për vitin 2024/2026, ne nga drejtoria e financave s'bashku me Kuvendin, kemi organizuar debatet publike me qytetarët organizatat joqeveritare dhe grupet joformale, të cilat janë në territorin e komunës së

Procesverbali i Kuvendit

Novobërdës. Debatet publike janë organizuar në vendet Bostan, Kufcë e epërme, Stanishor, Llabjan, Pasjak, po ashtu në Kufcë të eprëme është organizuar debate me organizat jojoqeveritare dhe grupet joformale, ne i kemi ndëgjuar hallet e qytetarëve dhe pasë kësaj edhe e kemi përgaditur buxhetin për vitin e ardhshëm. Në pika të shkrutra do t'ju prezanoj buxhetin për vitin e ardhshëm i cili është në vlerë prej 3,925,195 € për paga dhe mëditje janë 2,807,630 € shërbimet komunale 465.781 €, subvencionet 280.000 €, investimet kapitale 271.784 €, të gjitha i keni në material edhe projektet që i kemi propozuar, nëse keni ndonjë pyetje jamë i hapur për përgjigjëje ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: Sa i përket kësaj pike ju ditën e fundit i keni dërguar listën e projekteve kapitale ne tani po i shohim projektet, për këtë arsy nuk e kamë votuar rendin e ditës pse nuk na është dërguar lista e projekteve 7 ditë më herët, ky buxhet për mua është shqetësues për investime tek qytetarët qoftë t'ju rregullohet infrastruktura për shkak se shpenzimet kryesishtë po i keni për paga dhe mëditje e pikërishtë shumica prej tyre nuk e bëjnë asnijë detyrë, punë e kemi rastin e shoqatës ku sot po kërkohet t'ju ndahet buxhet që të rrinë në shtëpitë e tyre e kjo është pasojë të cilën do ta bart qeveria lokale për shkak qytetarët po pësojnë, pasi jemi te kjo pikë e renditë të ditës unë e kamë një propozim do të përbushen nevojat e qytetarëve është një projketë 31.000 € ku vlerat janë nga 10.000 9.000 5.000 € propozoj që në lagjen Sallkaj të asfaltohet rruga lagjen Abazaj ndriqimi, Gërbeshaj ndriqimi, asfaltimi i rrugës Islami Vllasali, ndriqimi Makresh, vazhdimi i ndriqimit në fsh.Kosaqë ndriqimi i urës në Zebincë, ndriqimi i urës në Brus, ndriqimi në lagjen Zeqiraj, asfaltimi i rrugës Zeqiraj, ndriqimi i lagjës Zenaj trotuari Stanishor, ndriqimi Bunjak, ndriqimi i rrugës te Kalaja, vazhdimi i rrugës Beqaj, asfaltimi i rrugës, Kufcë te shqiptarët, rruga Shaqiraj Vllasali, rregullimi i ndriqimi në Pasjak, kanalizimi në Pasjak, ndërtimi i rrugës te Raif Sylejmani, ndërtimi i qeshmës së vjetër Zeqiraj, asfaltimi rrugës te Gani Vllasaliu, ndërtimi i shkallëve në Koznicë, hapja pusit të ujit në shkollën e Koznicës, ansjëra nga këto projekte nuk është në listë andaj kërkoj që të futen këto në listë të projekteve, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: Ne si administratë e Kuvendit ju kemi dërguar listën e projekteve, materialin e keni marë me kohë.

Selatin Nuhiu tha: E kam një pyetje për drejtorin e financave sa përqind e projekteve është realizuar në investime kapitale? Sa janë përfunduar dhe sa do të mbisin investime kapitale? Ka dy apo tri vite kemi projekte të cilat futen vazhdimishtë në projekte kapitale, e dinë mirë Ramush Mehmeti dhe të tjerët që po futen këto projekte pa mbulesë, para dy viteve kanë qenë fontan dëshirash, vetëm për të fituar vota gjatë fushatës zgjedhore, të cilat nuk realizohen ato projekte fare. E kamë një pyetje konkret rrëth hapjes së pusit në sh.fillore në Koznicë, ku e kemi aprovuar vitin e kaluar deri ku ka arritur procedura, po ashtu ndriqimi në lagjen Talaj deri te Zabeli, deri ku ka arritur procedura? Kanalizimi, vitin e kaluar është aprovuar ku Ramushi e ka dërguar te daja, në lagjen e re, ka edhe shumë projekte të tjera, pasi buxheti është aprovuar, vitin e kaluar besoj që keni pasur mbulesë, deri ku kanë arritur ato procedura, po ashtu mirëmbajtja e rrugëve lokale, të cilat janë ndarë mjete rrëth 30.000 €, nuk e kamë parë që është mirmbajtë ndonjë rrugë në komunën tonë, ato mjete kanë shkuar në një fshatë, ndërsa e dimë që në fsh.Llabjan, gjatë pranverës verës ka pasur disa të reshura, janë nxanun edhe kanalizimet, janë prishur rrugët, ura është prishur në Llabjan, çfarë kandodhur me ato mjete të mirëmbajtjes së rrugëve? Po ashtu për buxhetin e viti 2024, po i shoh disa shuma që janë ndarë, ne dimë kush I bon edhe kush është ekspertë për palën shqiptare, psh.asfaltimi i rrugës në fsh.Llabjan 10.000 €, në Llabjan ka shumë lagje, kur po ju duhen për vota po i bëjne projekte për lagjen Talaj, Sallkaj, Abazaj, cila lagje është në shumë prej 10.000 €,

Procesverbali i Kuvendit

tjetra ndërtimi I ndrqimit publik 5.000 €, asfaltimi 10.000 € ndriqimi 5.000 €, kisha dashur me ditë për cilat lagje janë ndarë ato mjete pasi që Llabjani ka shumë lagje, edhe ene nuk duhet të ndahemi si asambleistë të na pyetni edhe neve pasi kemi edhe ne propozime për t'i futur projektet në listën e investimeve kapitale, problem është edhe në Novobërdë në lagjen Kolonia e vjetër asnjëher nuk është investuar asgjë, ujin ata po e paguajnë me vetë financim ka një jav ditë që nuk ka ujë të pishëm, askush nuk interesohet se çfarë po ndodhë me ata njerëz a kanë ujë a jo është shkolla, edhe institucionet e tjera policia, ambulanca, një banes është renovuar para dy viteve është ndarë një buxhet, është dashur edhe këtë vitë të ndahet një shumë e caktuar për rregullimin e dy ndërtesave tjera, të miren parasyshë edhe kërkesat e tona si anëtar, mua si anëtar i K.K-së askushë nuk më ka ftuar, edhe ne i kemi kërkesat, vërejtjet, jemi zgjedhur nga qytetarët andaj nëse ka mundësi drejtorit të më përgjigjet në këto pyetje ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: Është dashur që të zgjidhen disa sende elementare si uji i pishëm, rregullimi i kanalizimeve të cilat janë të dëmtuara, po rrezikohemi me ndonjë epidemi, të bëhen renovimet nëpër shkolla etj jeni muduar të bëni diqka por nuk keni bërë asgjë me 10.000 € nuk ndërtohet rruga, një urë nga vërshimet është totalishtë e bllokuar, nuk e keni gjetur vullnetin të shkoni dhe ta largoni një dru i cili është rrëxar nga vërshimet, pra nuk ka gadishmëri për pune.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 13 vota për 1 abstenim u prua ky:

V E N D I M

Aprovohet buxheti i Komunes për vitin 2024/2026.

Pika e tretë: Raport mbi përfundimin e fushatës së korrje-shirjeve.

Kryesuesja për këtë pikë fjalën ja dha drejtorit të bujqësisë.

Drejtori i bujqësisë pasi përshëndeti të pranishmit tha: Sa i përket fushatës së korrje-shirjeve ka filluar në dy fazë. Faza e parë ka filluar me datën 10.07.2023 me kulturën elbë, rendimentet e dhanuna të deklaruara nga fermerët për një (1) elbë: 1500 kg sipërfaqe të korrura me kulurën janë gjithësej 81.39 ha. Faza e dytë ka filluar me datën 15.07.2023 me kulturën grurë, thekër, tershë, rendimentet e dhanuna të deklaruara nga fermerët për një ha grurë 2055 kg sipërfaqe të korura me kulturën grurë 784.68 ha. Rendimentet e dhanuna të deklaruara nga fermerët për një ha thekërr 1800 kg sipërfaqe të korura me kulturën thekërr 35.11 ha. Rendimentet e dhanuna të deklaruara nga fermërt për një (1) ha tershë 800 kg sipërfaqe të korrura me kulturën tershë 63.21 ha. Korrja shirja në komunën e Novobërdës është kryer me sukses pa incidente në terenë si nga ana e fermerëve njëashtu edhe nga ana e autokombanjerëve. Korrjen - shirjen e kanë kryer me çmim nga 150 € për një (1 ha) korrjen shirjen kanë marrë pjesë 18 autokombanja, korrja shirja ka përfunduar me datën 26.08.2023. Sipërfaqe të korrje shirjeve në të gjitha kulturat bujqësore janë gjithësej 964.39 ha, nuk dua të zgjasë më shumë nëse keni ndonjë pyetje jamë I hapur për përgjigjëje ju faleminderit.

Selatin Nuhiu tha: Më herët kërkova përgjigjëje nga drejtori i financave duhet të na respektoni si anëtar që jemi kjo është fyerje, buxheti njëher në vitë aprovohet kërkesat e mia që ishin, nuk u morën parasyshë, materialin e K.K-së e kemi marrë me kohë ndërsa listën e projekteve na keni pru ditën e mbledhjes.

Kryesuesja tha: Në formë elektronike ju kemi dërguar gjithë materialin po ashtu edhe listën e projekteve kapitale sa i përket buxhetit, unë si Kryesuese ju respektoj, per çdo pikë gjithmonë jy pyes a ka dikush diqka të shtoj nëse nuk ka atë pikë e fus në votim.

Pasi nuk pati diskutime tjera u kalua në pikën tjetër të rendit të ditës.

Procesverbali i Kuvendit

Pika e katërt: Miratimi i vendimit për konfirmimin e vazhdimit të Memorandumit të Mirëkuptimit me shoqatën e zjarrfikësve vullnetarë nga Gjilan.

Kryesuesja për këtë pikë fjalën ja dha Drejtorit të shërbimeve publike.

DSHP Gafurr Vllasaliu pasi përshëndeti të pranishmit tha: Sa i përket kësaj pike vazhdimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me shoqatën e zjarrfikësve vullnetarë nga Gjilani nuk kemi ndonjë ndryshim, me angazhimi e vullnetarëve me shoqatën nga Gjilani, në stacionin e zjarrfikësve në komunën tonë, është më efektive dhe me intervenime më të shpejta, sa i përket dëmeve materiale, kemi më pak dëme për shkakë të punës së mirë me Drejtorin për mbrojtje dhe shpëtim na është dhuruar një veturë, nga Agjensia emërgjente e Kosovës në shërbim të punës, nuk dua t'ju marrë më shumë kohë nëse keni pyetje jamë i hapur për përgjigjëje ju faleminderit.

Pranvera Kastrati Gashi tha: Sa i përket këtij Memorandumi unë jamë kundër, për arsyen se nuk ka pasur transparencë, në marrjen e këtyre punëtorëve, pasi nuk ka pasur transparencë e kamë kërkuar edhe auditorin e brendshëm në drejtorin e shërbimeve publike, ku jemi në pritje të auditimit, nuk e shohë të aryseshme që t'ju vazhdohet këtyre punëtorëve kontrata edhe për muajt e tjerë, nuk ka pasur as konkrus jamë kundër kategorikishtë ju faleminderit.

Abdyl Gashi i kamë dy pyetje për drejtorin sa i ka kushtuar buxhetit të komunës për gjashtë muajt dhe sa do t'i kushtoj për tre muajt e ardhshëm, këta zjarrfikës kanë nevojë që të furizohen me shumë paisje, ne kemi pasur raste ku ka pasur edhe aksidente e që nuk i kanë sendet elementare, të rritet kapaciteti në cisterna të ujit pasi ka shumë pakë, prapë po e themë gjithçka po mundohet të jetë fushatë, të dëmtohet buxheti qindra mijëra euro dhe vijnë me projekte kapitale që nuk mund t'i shfrytëzojnë qytetarët, në vendë që të shfrytëzohen ato mjete për ndriqim, ujësjellës kanalizim, që t'ju shërbehet qytetarëve ato mjete shfrytëzohen për disa persona që më shumë rrinë në shtëpi, te konkurret si janë marrë ata qytetarë ndoshta është një rastësi që ka mundësi me qenë komplet familjar e zyrtarëve komunal, ata që kanë pasur nevojë më së shumti ata nuk janë përfshirë, megjithatë do të jetë në ndërgjegjëjn e atyre për këtë arsyen unë si anëtar s'bashku me lëvizjen kemi ngritur kallxim penal ku kemi kërkuar sqarim nga Prokuroria pasi ka keqëpërdorime të mëdha as unë nuk do ta votoj këtë pikë, unë jamë që qytetarëve t'ju bëhet zgjidhje e përhershme e jo e përkohshme, të punsohen njerzit me kontrata të rregullta, po ndodhin te organet shëndetësore që shkojnë të shërojnë njerëz e duhet të friksohen që mos po ndrron jetë sepse nuk e kanë as bazën elementare të përgaditjes profesionale për punën që e bëjnë, ashtu po ndodhë edhe në arsim i punësojnë brenda natës arsimtarët, ka edhe analfabet nga ata, këto gjëra duhet të shihen seriozishtë nuk ka hajgare, sidomos te arsimi, buxheti nuk është as i kryesuesit as i zv.kryesyesit ai është buxhet i qytetarëve ju faleminderit

Pasi nuk pati diskutime tjera me 13 vota për 2 kundër u prua ky:

V E N D I M

Aprovohet vendimi për konfirmimin e vazhdimit të Memorandumit të Mirëkuptimit me shoqatën e zjarrfikësve vullnetarë nga Gjilan.

Pika e pestë: Prurja e vendimit për ndalimin e përkohshëm e shitjeve së parcelave që kanë objekte pa leje deri në legalizim të objektit.

Procesverbali i Kuvendit

Kryesuesja tha: Më herët biseduam për këtë pikë, Kryetari e ka një kërkesë në bazë të Statutit nenit 10 pika b dhe d propozoj që të mirret vendimi për ndalimin e përkohshëm e shitjes së parcelave që kanë objekte pa leje deri në legalizim, pra deri në zgjidhjen e Statutit të tyre, e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pranvera Kastrati tha: Pajtohem me kolgët duhet të keni më shumë respekt dhe të mirren parasyshë edhe kërkesta e tona, unë kërkova 10 minuta pauzë që të diskutojmë për këtë pikë që e ka propozuar Kryetari i komunës të na sillni dokumentin ju nuk e morët parasyshë kërkesën time, as edhe njëherë kërkesat që i propozoj nuk i merrni parsyshë.

Kryesuesja tha: Deri më tanë si Adminsitrat e Kuvendit i kemi dërguar gjitha dokumentet dhe kërkesat ju që i keni propozuar drejtorive të caktuar ju kemi dërguar, unë prapë po e them ajo çfarë ëhstë në bazë të Ligjit mundemi ta bëjëm ajo çfarë nuk është nuk mundë ta bëjmë, sa i përket pikës shtesë të rendit të ditës ne e aprovojmë rendin e ditës kur vie te pika shtesë ne diskutojmë, nëse doni pauzë ne mundë ta marrim një pauzë ju faleminderit.

Pranvera Kastrati tha: Unë e votova prapë rendin e ditës me pikën shtesë, me arsyetimin dhe mendimin që do ta marrim një pauzë ta shohim dokumentin dhe ta votojmë, unë prapë e kërkoj pauzën.

Ramush Mehmeti tha: Kërkesat e anëtarëve janë të drejta, të arsyeshm, sa i përket pikave shtesë kryetari, drejtori anëtarë i kuvendit ka të drejtë të propozon, anëtarë i kuvendit nuk bje material por propozen pikë shtesë, nëse e mere miratimin e anëtarve tjerë të Kuvendit votohet, ka pasur raste që materiali ka shkuar vetëm në gjuhën sérbe pasi nuk është përkthyer në gjuhën shqipe.

Kryesuesja tha: E nderuara kolege ju keni pasur të drejtë ajo çfarë mundë të themë të marrim një pauzë prej 10 minutave dhe ta lexoni dokumentin, nuk ka pasur kohë për përkthim pasi ka ardhur me vonësë do të kemi 10 minuta pazuë.

Kryesuesja tha: Pasë pauzës materialin e kemi edhe në gjuhën shqipe, jeni në dijeni për çfarë bëhet fjalë e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pranvera Kastrati tha: E lexova dokumentin dhe ta marrim një vendim për ndalimin e përkohshëm e shitjeve së parcelave që kanë objekte pa leje deri në legalizim të objektit që janë dëmtuar. Me sa e kamë kuptuar te një parcel është ndërtuar një shtëpi nëse nuk është e legalizuar nuk mundë t'ja bartë burri gruas, vllau vllait etj.

Kryesuesja tha: Në shkresë shkruan që të mirret një vendim për ndalimin e përkoshshëm të shitjeve të parcelave që kanë objekte pa leje deri në legalizim të vitit 2018, pra deri në zgjidhjen e Statutit të tyre, shkruan shumë kjartë në dokument.

Stojan Stanojeviq tha: Ështe e kjartë ne që të mbështetemi te Statuti, Statuti bëhet në bazë të Ligjit, ajo çfarë dua të them, me gjitha lavdërimet dikush më në fundë, është kujtuar që disa gjëra të rregullohen, në bazë të Ligjit unë nuk mundë ta kuptoj që dikush mundë të ndërtoj, të shesë objekte të pa legalizuara, prona të cilat nuk janë të tyre ju faleminderit.

Selatin Nuhiu tha: Pse deri në vitin 2018 pse jo deri në vitin 2022, nëse ka mundësi ndonjë sqarim?

Drejtori i Urbanzimit tha: Nga Ministria është vendimi që objektet të cilta janë ndërtuar deri në vitin 2018, mundë të legalizohen, pasë vitit 2018 nuk mundë të legalizohen dhe janë inspektoret të cilët e ndalojnë ndërtimin e objekteve të parcelave të cilat janë bujqësore, së pari duhet të marrin leje ndërtimi pastaj të fillojen me ndërtimin, deri në vitin 2018 ka qene e lejuar legalizimi, ne nuk mundë të kërkojmë që të legalizohen objektet të cilat janë ndërtuar pas vitit 2018 ju faleminderit.

Procesverbali i Kuvendit

Kryesuesja tha: Me sa e kemi kuptuar deri në vitin 2018 të gjithëve ju është dhënë shansa ju është lejuar legalizimi, pasë vitit 2018 askushë nuk mundë të ndërtoj objekte, nëse nuk e ka lejen ndërtimore.

Abdyl Gashi tha: Ju I nderuar drjetor kur e keni marrë postin e drejtorit a keni ngritur ndonjë shqetësim apo kallzim penal, nga ana e inspekcionit që t'ju spjegohen proceudrat me cilat mundësi ka me ndërtu objektin, disa kanë ndërtuar çfarë do të behet me to ju vetëm po thoni që mirret niveli qendror, nuk është aq e thjeshtë, kjo është pune e inspektoriatit me ndërpren punën, ne kemi informata që shumë zyrtarë komunal i kanë dëmtuar ata njerëz, ju kanë thënë vazhdoni ju investoni e tash të krijojen probleme në një farë mënyre inspektorat rrinë rehat. Ne si Lëvizje sa her e kemi marrë pushtettin kemi gjetur dosje parrgullësi edhe po besoj paska mjaftë material për tu marrë me këtë pune, unë nuk jamë i saktë dhe ekspertë i kësaj fushe që na kemi të drejtë ta marim ndonjë vendim si ky ju faleminderit.

Kryesuesja tha: Ne si Kuvend sa herë që i marrim vendiemt i dërgojmë në Ministri për vlerësim në MAPL dhe ata e vlerësojnë a është ai vendim në bazë të Ligjit apo jo, nëse nuk është ata e kthejnë ju faleminderit.

Pasë diskutimeve që janë bërë me 14 vota për 1 abstenim u prua ky:

V E N D I M

Për ndalimin e përkohshëm të shitjeve së parcelave që kanë objekte pa leje deri në legalizim të objektit.

Pika e gjashtë: Të ndryshme.

Kryesuesja e hapi diksutimin për këtë pikë.

Stojan Stanojeviq tha: Më vje keq që nuk është prezentë drejtori i shërbimeve publike, e kamë një vërejtje në lidhje me kontenjerët, në tre muajt e fundit, janë ardhur vëtmë njehëre për pastrim i kamë disa foto, unë përmes Kryetarit kamë intervenuar dhe e japë në sugjerim që në të ardhmen, shoferet sillen skur te janë prona tyre kamionet dhe inkasantët nuk shkojnë shtëpi për shtëpi që t'i shpërndajnë faturat ju lusë që dikush që është kompetnet në mbledhjen e radhës të jetë prezentë dhe të na njofotj për këtë çështje ju faleminderit.

Kryesuesja tha: Ne do ta përcjellim këtë ankesë si administratë e Kuvendit dhe në mbledhjen e radhës t'i ftojmë zyrtarët për ndonjë raport.

Abdyl Gashi tha: Ne kemi kërkuar që disa persona të hiqen nga pagesa e kemi votuar një listë kemi diskutuar për disa emra, njëri është me nevoja të veçanta dhe tjetri i ka dy fëmijë me nevoja të veçanta, edhe zv.kryesuesi i dinë kush Jane besoj që këta emra të lirohen nga pagesa e Ekohipgjenës ju faleminderit.

Kryesuesja tha: Ne do ta përcjellim kerkesën kompanisë Ekologjia dhe nëse ata i plotësojnë kushtet besoj që edhe kompania do t'i liron nga pagesa ata njerëz ju faleminderit.

Procesverbali i Kuvendit

Pranvera Kastrati kërkoj që të ndërrohen ndëgjueset pasi po kamë probleme me ndëgjim ju faleminderit.

Kryesuesja tha: Do ta përcjellim edhe kérkesën e juaj nëse mundë të bëjmë diqka.

Selatin Nuhiu tha: Pajtohem me kolegun që kompania Ekologjia të vie në mbledhje dhe të na njoftojnë më gjërsishtë ne para disa muajve kur e kemi aprovuar që kjo kompani të punoj në komunën tonë, si anëtar kamë kerkuar që të lirohen nga pagesa rastet sociale si dhe kategorite si veteranët e UCK-së dhe personat me nevoja të veçanta, e kemi rastin konkret nga komuniteti romë z.Naser Jashari, ka kerkuar që të futet në rend dite lirimi nga pagesa e mbeturinave për personat me nevoja të veçanta nuk është marrë parasyshë fare kérkesa e tij ju faleminderit.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

Sylejman Avdiu
Procesverbali

Mirjana Simijonović
Kryesuesja Kuvendit

